LIGJ
Nr. 59/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR POLITIKËN PËR ZHVILLIM PËR AKSESIN E BARABARTË GJINOR NË MUNDËSITË EKONOMIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për politikën për zhvillim për aksesin e barabartë gjinor në mundësitë ekonomike, në shumën 9 100 000 (nëntë milionë e njëqind mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.4.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11479, datë 8.5.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

HUAJA NUMËR 9032-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(HUA PËR POLITIKËN PËR ZHVILLIM PËR AKSESIN E BARABARTË GJINOR NË MUNDËSITË EKONOMIKE)
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshja, data e së cilës është data e nënshkrimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi") dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka"), me qëllim ofrimin e financimit në mbështetje të Programit (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje). Banka ka vendosur ta sigurojë këtë financim, ndër të tjera, në bazë të: i) masave tashmë të marra nga Huamarrësi në kuadër të Programit, të përshkruara në seksionin I A, të skedulit 1, të kësaj Marrëveshjeje; dhe ii) ruajtjes së një kuadri të përshtatshëm makroekonomik nga Huamarrësi. Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (të përcaktuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me shkronja të mëdha shtypi të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit shumën prej nëntë milionë e njëqind mijë euro (EUR 9,100,000) siç kjo vlerë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet konvertimit të monedhës ("Huaja").

2.02 Tarifa që parapaguhet në fillim të transaksionit është sa çereku i një përqindëshit (0.25%) të shumës së Huas.

2.03 Tarifa vjetore e Angazhimit është një e katërta e një përqindëshit (0.25%) e Bilancit të Huasë së Patërhequr.

2.04 Norma e interesit është norma e referencës plus marzhi i pandryshueshëm ose norma që mund të aplikohet pas këmbimit, parashikuar në seksionin 3.02 (e) të kushteve të përgjithshme.

2.05 Datat e pagesës janë 15 maji dhe 15 nëntori i çdo viti.

2.06 Vlera e principalit të kësaj Huaje do të shlyhet në përputhje me skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 Pa u kufizuar prej dispozitave të seksionit 5.05 të kushteve të përgjithshme, Huamarrësi i paraqet Bankës menjëherë informacionin në lidhje me dispozitat e nenit II, siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Banka herë pas here.

Neni 3
Programi

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për Programin dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim, dhe në vijim të seksionit 5.05 të kushteve të përgjithshme:

a) Huamarrësi dhe Banka, me kërkesë të secilës palë, shkëmbejnë herë pas here mendime mbi kuadrin e politikave makroekonomike të Huamarrësit dhe progresin e arritur në zbatimin e Programit;

b) pa u kufizuar nga paragrafi a i këtij seksioni, Huamarrësi e informon Bankën menjëherë për çdo situatë që do të sillte si pasojë ndryshimin nga pikëpamja materiale të objektivave të Programit ose të çfarëdo veprimi të ndërmarrë nga Programi, duke përfshirë çdo veprim të specifikuar në seksionin I, të skedulit 1, të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Mjetet efektive të bankës

4.01 Rasti Shtesë i Pezullimit nënkupton krijimin e një situate, e cila e bën të pamundur realizimin e Programit ose të një pjese të konsiderueshme të tij.

4.02 Rasti Shtesë i Përshpejtimit nënkupton që rastet e përcaktuara në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje kanë ndodhur dhe vazhdojnë për një periudhë 30-ditore pas njoftimit që Banka i ka dhënë Huamarrësit për rastin.

Neni 5
Efektiviteti

5.01 Kushti Shtesë për Efektivitetin përbëhet nga sa më poshtë: përkatësisht Banka është e kënaqur me progresin e arritur nga Huamarrësi në zbatimin e Programit dhe me përshtatshmërinë e kuadrit të politikës makroekonomike të Huamarrësit.

5.02 Afati i hyrjes në fuqi është 120 (njëqind e njëzetë) ditë pas datës së nënshkrimit.

Neni 6
Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave dhe Ekonomisë.

6.02 Për qëllimet e seksionit 10.1 të Kushteve të Përgjithshme: a) Adresa e Huamarrsit është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3 Tiranë, Shqipëri dhe

b) Adresa elektronike e Huamarrësit është:

Faksimile: 355-4222-8494

E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

6.03. Për qëllimet e seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme: a) adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim 1818 H Street, N.W. Washington, D.C. 20433 Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

Teleks:

Faksimile: e-mail:

248423(MCI) ose 1-202-477-6391 msaliml@worldbank.org 64145(MCI)

RËNË DAKORD në datën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga

_____
Përfaqësuesi i autorizuar
Emri: ANILA DENAJ
Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Data: 15 janar 2020

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Nga:

_____
Përfaqësuesi i autorizuar
Emri: LINDA VAN GELDER
Titulli: Drejtor Vendi
Data: 15 janar 2020

SKEDULI 1
MASAT E PROGRAMIT; DISPONUESHMËRIA E TË ARDHURAVE TË HUAS

Seksioni I
Masat në bazë të këtij Programi

A. Masat e marra në kuadër të Programit. Masat e ndërmarra nga Huamarrësi në bazë të këtij Programi përfshijnë sa më poshtë vijon:

i) Noterë të autorizuar të njohin bashkëpronësinë mbi pasurinë e paluajtshme të fituar gjatë martesës, në kuadër të regjimit martesor të pasurisë, për të mbrojtur të drejtat pronësore të bashkëshortëve në procesin e transferimit ose trashëgimisë së pasurisë së paluajtshme, nëpërmjet: a) verifikimit të gjendjes martesore të palëve të përfshira në transferimin e pronës së paluajtshme; b) njohjes së rregullt të bashkëpronësisë në dokumentet noteriale, nëse pasuria e paluajtshme është vënë gjatë martesës; dhe c) sigurimi që aktet e trashëgimisë nuk shkelin bashkëpronësinë mbi pasurisë së paluajtshme të vënë gjatë martesës, siç dëshmon ligji për noterinë nr. 110/2018, datë 20 dhjetor 2018, botuar në Fletoren Zyrtare, më 13 shkurt 2019.

ii) Agjencia e Kadastrës Shtetërore të Huamarrësit ka nxjerrë udhëzime për zyrat e regjistrimit për të korrigjuar emrat në kartelat e pasurive të paluajtshme të regjistruara në emër të njërit bashkëshort, që supozohet të jetë bashkëpronar, për të korrigjuar nënregjistrimin e bashkëpronareve femra në regjistrat ekzistues të pronës në Shqipëri, siç dëshmon urdhri nr. 1150, i drejtorit të Agjencisë së Kadastrës Shtetërore të Huamarrësit, datë 3 qershor 2019, botuar në Fletoren Zyrtare, më 11 qershor 2019.

iii) Huamarrësi ka: a) hartuar rregulla për autorizimin, përzgjedhjen dhe financimin e ofruesve jofitimprurës të ndihmës juridike parësore dhe dytësore; b) ngritur një sistem për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave për ofruesit e ndihmës juridike; dhe c) hartuar udhëzime për kontaktimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të ndihmës juridike, për të përmirësuar ndihmën juridike që mund të mbështesë korrigjimet e pronësisë dhe bashkëpronësisë mbi titujt e pasurive të paluajtshme, siç dëshmohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, 6 mars 2019, botuar në Fletoren Zyrtare, më 15 mars 2019 dhe urdhrin e ministrit nr. 226, datë 25 mars 2019.

iv) Huamarrësi përmes Autoritetit të Prokurimit Publik, ka ndryshuar dokumentet standarde të tenderit për tenderat e prokurimeve publike me vlerë 8 milionë lekë ose më shumë, për të rritur ndërgjegjësimin për aspektet e barazisë gjinore të Kodit të Punës, duke kërkuar që firmat të deklarojnë respektimin e: a) parimeve të mosdiskriminimit për kontratat kolektive dhe kontratat individuale; dhe b) parimet e mosdiskriminimit të cilat përfshijnë pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë, për të nxitur më shumë praktika të barabarta gjinore në sektorin privat, siç dëshmohet nga vendimi i drejtorit, datë 20 qershor 2019 dhe memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Autoritetit të Prokurimit Publik dhe Inspektoratit të Punës së Huamarrësit, datë 14 qershor 2019.

v) a) Rregulli i transferimit të buxhetit për buxhetet bashkiake për sistemin parashkollor është ndryshuar për të kaluar nga financimi për mësues në financimin për nxënës; dhe b) Huamarrësi ka filluar një program pilot për nxënien pas shkollës për nxënësit në klasave 1–9, për të përmirësuar cilësinë dhe disponibilitetin e arsimit parashkollor dhe bazë, si dhe për t'u krijuar mundësi grave me fëmijë që të bëhen pjesë e tregut të punës, siç dëshmohet nga ligji nr. 99/2018, datë 3 dhjetor 2018, botuar në Fletoren Zyrtare, më 21 dhjetor 2018; udhëzimi i Ministrisë së Financave, datë 17 janar 2019 dhe urdhri i ministrit nr. 760, datë 16 nëntor 2018.

vi) Ligji "Për nxitjen e punësimit", është miratuar dhe synon të: a) përmirësojë ofrimin e shërbimeve të punësimit për pjesëtarët e grupeve në nevojë, siç përcaktohet në ligjin shqiptar, përfshi gratë e reja, gratë beqare prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, nga pakicat etnike dhe viktimat e trafikimit dhe dhunës gjinore dhe në familje; dhe b) ofrojë subvencione për shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve për gratë e regjistruara në bazën kombëtare të të dhënave për shërbimet e punësimit, për të zgjeruar mundësitë e tregut të punës për gratë, veçanërisht gratë në nevojë, siç parashikohet në ligjin nr. 15/2019, datë 13 mars 2019, botuar në Fletoren Zyrtare, më 3 prill 2019.

vii) Huamarrësi ka: a) përcaktuar procedura për monitorimin e shpenzimeve publike të lidhura me gjininë nga qeverisja vendore; dhe b) integruar buxhetimin përkatës gjinor në Sistemin e Informacionit të Menaxhimit Financiar të Shqipërisë (AFMIS), për të monitoruar më mirë politikat dhe programet gjinore, siç specifikohet në udhëzimin nr. 22 të ministrit , datë 30 qershor

2018 dhe urdhrin nr. 527 të ministrit datë 25 korrik 2019, botuar në Fletoren Zyrtare, më 28 korrik 2019.

viii) Huamarrësi ka hartuar një Indeks të Barazisë Gjinore, që merr miratimin e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), për të përmirësuar monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve gjinore, siç dëshmohet nga komunikimet zyrtare nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore, datë 5 shtator 2019.

Seksioni II

Disponueshmëria e fondeve të Huas

A. Të përgjithshme. Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me dispozitat e këtij seksioni dhe udhëzimet e tjera shtesë që mund të specifikohen nga Banka, duke njoftuar Huamarrësin.

B. Alokimi i shumave të Huas. Huaja (me përjashtim të shumave të kërkuara për të paguar Tarifën e Parapagimit) jepet në një transh të vetëm tërheqjeje, nga i cili Huamarrësi mund të bëjë tërheqjen e të fondeve të Huas. Shpërndarja e shumave të huas për këtë jepet në tabelën e mëposhtme:

Alokimet	**Vlera e huas së dhënë (e shprehur në euro)**
1. Transhi i vetëm i tërheqjes	9,077,250
2. Tarifa e parapagimit	22,750
3. Shuma për t'u paguar në përputhje me seksionin 4.05 (c) të kushteve të përgjithshme	0
SHUMA TOTALE	**9,100,000**

C. Kushtet e lëshimit të transhit të tërheqjes

Asnjë tërheqje nuk do të bëhet nga Tanshi i vetëm i tërheqjes përveç nëse Banka është e kënaqur: a) me Programin që kryhet nga Huamarrësi; dhe b) me përshtatshmërinë e kuadrit të politikës makroekonomike të Huamarrësit.

D. Depozitimi i shumave të huas

Huamarrësi, brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas tërheqjes së Huas nga Llogaria e Huas, duhet t'i raportojë Bankës: a) shumën e saktë të marrë në llogarinë e përmendur në seksionin 2.03 (a), të kushteve të përgjithshme; b) detajet e llogarisë ku do të kreditohet ekuivalenti në lekë i të ardhurave të huas; c) të dhënat që dëshmojnë se shuma ekuivalente është llogaritur në sistemet e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit; dhe d) deklaratën e faturave dhe pagesave të llogarisë të përmendur në seksionin 2.03 (a) të kushteve të përgjithshme.

E. Data e përfundimit. Data e përfundimit është 31 mars 2021.

SKEDULI 2

SKEDULI I SHLYERJES SË AMORTIZIMIT TË LIDHUR ME ANGAZHIMIN

Tabela në vijim përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjet e vlerës totale të principalit të Huas të pagueshme në secilën datë pagese të principalit ("Përqindja e kështit").

Shlyerjet e principalit me këste fikse

Data e pagesës së principalit	**Vlera e kështit**
Çdo datë 15 maj dhe 15 nëntor Duke filluar nga 15 nëntor, 2026 Deri më 15 nëntor, 2041	3.13 %

Më 15 maj, 2042	2, 97 %

SHTOJCA A

Seksioni I
Përkufizime

1. "Kushtet e përgjithshme" janë "Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e BNRZH-së, financimi i politikave për zhvillim", datë 14 dhjetor 2018.

2. "Lekë" është monedha vendase e Huamarrësit.

3. "Program" është programi i objektivave, i politikave dhe i masave të përshkruara ose të përmendura në shkresën e datës 21 qershor 2019 nga Huamarrësi drejtuar Bankës, ku deklarohet angazhimi i Huamarrësit për ekzekutimin e Programit dhe ku kërkohet ndihmë nga Banka në mbështetje të Programit gjatë ekzekutimit të tij dhe veprimeve të ndërmarra, duke përfshirë ato të përshkruara në seksionin I, të skedulit 1, të kësaj Marrëveshjeje dhe veprimeve që do të ndërmerren në përputhje me objektivat e programit.

4. "Data e nënshkrimit" është data më e vonë midis dy datave në të cilat Huamarrësi dhe Banka nënshkruajnë këtë Marrëveshje dhe ky përkufizim zbatohet për të gjitha referencat ndaj "datës së Marrëveshjes së Huas" në kushtet e përgjithshme.

5. "Transh me një tërheqje të vetme" është vlera e huas e caktuar për kategorinë e titulluar "Transhi me një tërheqje të vetme", në tabelën e paraqitur në pjesën B, të seksionit II, të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.